



**REPUBLIKA E SHQIPERISE  
KESHILLI I MINISTRAVE**

**PROJEKT-VENDIM**

**Nr. \_\_\_\_\_ Date. \_\_\_\_\_ 2009**

**“PER REALIZIMIN E SHERBIMIT FINANCIAR TE  
VLERESIMIT TE RISKUT TE VENDIT” (Credit Rating)**

Ne mbeshtetje te nenit 100 te Kushtetutes, te nenit 7 germa ç te ligjit nr. 9643 date 20.11.2006 “Per Prokurimin Publik” i ndryshuar, me propozim te Ministrit te Financave, Keshilli i Ministrave,

**VENDOSI:**

1. Ky vendim zbatohet per percaktimin dhe realizimin e procedures qe do te ndiqet per zhvillimin e procesit te Credit Rating per Qeverine e Republikes se Shqiperise.
2. Credit rating, ne kuptim te ketij vendimi, pershin sherbimin financiar ne formen e procesit vleresues te riskut te vendit, duke ofruar sherbimin e nevojshem per realizimin e procesit te transaksioneve te huamarrjes ne tregun nderkombetar.
3. Procedura e realizimit te ketij sherbimi financiar percaktohet si me poshte:

Titullari, nxjerr urdhrin per realizimin e ketij sherbimi financiar. Urdhri duhet te permbaje detyrimisht:

- a) sherbimin financiar qe eshte objekt i kesaj procedure.
- b) listen e institucioneve financiare pjesemarrese per te ofruar sherbimin e kerkuar, e cila do te percaktohet nga Komisioni i Hartimit te Dokumentave.
- c) perberjen dhe emrat e anetareve te Komisionit te Hartimit te Dokumentave dhe atij te Vleresimit te Ofertave, te cilet duhet te permbajne se paku nje kryetar dhe 2 specialiste te fushes. si dhe cdo element tjeter te vleresuar si te nevojshem.

4. Komisioni i Hartimit te Dokumentave, brenda 5 diteve nga dalja e urdhrin, pergatisin ftesen e nevojshme per oferte dhe e dergojne ate ne adresat perkatese. Ftesa duhet te permbaje:

- a) institucionin qe kryen proceduren per sherbimin sipas pikes 1
- b) sherbimin financiar qe kerkohej te realizohet
- c) kushtet specifike te kerkuara dhe
- d) daten, oren dhe vendin e paraqitjes se ofertes.

5. Dokumentacioni i paraqitur nga subjektet e interesuara, ruhet dhe nuk hapet nga Komisioni i vleresimit te ofertave deri ne daten dhe oren e caktuar ne ftese.

6. Ne marrjen e vendimit perfundimtar per perzgjedhjen e subjektit, komisioni i vleresimit te ofertave, bazohet respektivisht si me poshte:

a) plotesimin e kriterëve te pergjithshme dhe teknike,

b) cilesine e sherbimit te ofruar dhe reputacionin ne tregjet financiare me te njohura boterore.

c) cmimim me te ulet per sherbimin e ofruar nga subjektet, per blerjen, shitjen/transferimin e instrumentit financiar.

Pesha specifike e secilit prej kriterëve te siperpermendur, do te percaktohet ne dokumentat e tenderit dhe do t'u njoftohet institucioneve financiare pjesemarrese.

7. Titullari i institucionit, ne baze te vendimit te dhene nga Komisioni i Vleresimit, miraton ose refuzon, brenda 5 ditesh shpalljen e fituesit.

8. Komisioni i vleresimit te ofertave, brenda 5 diteve nga shpallja e fituesit, njofton te interesuarit, per klasifikimin perfundimtar te ofertave.

9. Ankesat e subjekteve ndaj procedures se zhvilluar, i paraqiten brenda 5 diteve nga data e njoftimit titullarit te institucionit. Vendimi, jepet brenda 5 diteve nga paraqitja e ankeses, dhe eshte perfundimtar. Njoftimi perfundimtar i fituesit do te behet me te gjitha mjetet e komunikimit.

10. Ngarkohet Ministria e Financave per zbatimin e ketij akti.

Ky vendim hyn ne fuqi menjehere.

**KRYEMINISTER**

**Sali BERISHA**

MINISTER I FINANCAVE

Ridvan BODE